



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË
KORÇË

VENDIM
Nr 126 Datë 03.12.2010

PER
Miratim fondi për Shkollën Speciale, Qendrën Rezidenciale të Zhvillimit dhe
Qendrën Ditore të Zhvillimit

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës "Miratim fondi për Shkollën Speciale, Qendrën Rezidenciale të Zhvillimit dhe Qendrën Ditore të Zhvillimit, bazuar në ligjin nr. 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 32 pika dh, ligjin nr. 10190 dt. 26.11.2009 «Për buxhetin e vitit 2010», Udhëzimin nr.1 dt.21.01.2010 M.F «Për zbatimin e buxhetit të vitit 2010», V.K.B nr. 20 dt. 25.03.2010 « Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2010», Ligji nr. 9936 dt. 26.06.2008 «Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë» dhe mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

1. Të miratoje fondin prej 310,000 lekësh për festat e nëntorit, për 3 dhjetorin «Dita Ndërkombëtare e njerëzve me aftësi të kufizuara» dhe festave të fundvitit, konkretisht :
Shkolla Speciale 50,000 lekë për blerje dhuratash për nxënësit e saj,
Qendra Rezidenciale e Zhvillimit 200,000 lekë si më poshtë:
30,000 lekë për festat e 28,29 nëntorit
50,000 lekë koktejl për 3 dhjetorin
50,000 lekë blerje dhurata
70,000 lekë blerje ushqime
Qendra Ditore e Zhvillimit 60,000 lekë për blerje dhuratash dhe organizimin e një kokteili
2. Ky fond do të përballohet nga fondi i shpenzimeve operative (kësti i kredisë) me këtë strukturë buxhetore :

PAKESOHET	00	01110 05	Art. 6020000	-310,000 lekë (Bashkia)
SHTOHET	00	10140 05	Art. 6020000	+260,000 lekë (QRZH,QDZH)
SHTOHET	00	09120 05	Art. 6020000	+ 50,000 lekë (Arsimi 9 vj)

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Arsimi 9 vj, Qendra Rezidenciale e Zhvillit dhe Qendra Ditore e Zhvillimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Kryetari

GJERGJLPENDAVINTI



Dixhitalizuar nga Qendra QIP
www.infocip.org